Lajmet e Fundit: Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit Drejtues Madhor Gledis Nano prezantoi ditën e sotme, Rektorin e ri të Akademisë së Sigurisë Prof/Dok Ilirjan Mandro



Lajmet

23/05/2022

Elbasan – Arrestohet në flagrancë 1 shtetas, procedohen penalisht 6 të tjerë për vepra të ndryshme penale

Specialistët e Hetimit të Krimit të Komisariatit të Policisë Cërrik arrestuan në flagrancë shtetasin S. Ç., 59 vjeç, banues në fshatin Rrushbull, Durrës, për veprën penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit", pasi në fshatin Topojan, Cërrik, gjatë kontrollit në stallën e bagëtive iu gjetën dhe u sekuestruan në cilësinë e provës materiale një armë zjarri automatik dhe një sasi fishekësh.

—

Specialistët e Hetimit të Krimit të Komisariatit të Policisë Elbasan referuan materiale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Elbasan, për shtetasen A. K., 51 vjeçe, banuese në fshatin Shushice, Elbasan, për veprën penale "Dhuna në familje", pasi ka goditur me shuplakë në fytyrë, kunatën e saj shtetasesn V. K.

Specialistët e Hetimit të krimit të Komisariatit të Policisë Librazhd referuan materialet në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Elbasan, për shtetasit :

-I. K., dhe M. K., 17 vjeç, banues në fshatin Prrenjas, Librazhd, për veprat penale "Plagosja e lehtë me dashje" e kryer në bashkëpunim, pasi gjatë një konflikti për motive të dobta kanë goditur me grushta shtetasit M. K., dhe B. K.

-F. Ç., 59 vjeç, banues në lagjen Nr.16, Durrës, për veprën penale "Kanosja", pasi në fshatin Drakostunjë, Librazhd, për motive të dobta ka kanosur me fjalë shtetasen N. Ç., 13 vjeçe.

-M. D., 59 vjeç, banues në Durrës, për veprën penale "Ndërtimi i paligjshëm", pasi në fshatin Dardhë, Librazhd, u konstatua se ka kryer punime ndërtimi, pa lejen përkatëse.

Specialistët e Hetimit të krimit të Komisariatit të Policisë Gramsh referuan materiale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Elbasan, për shtetasit :

-P. S., 54 vjeç, banues në fshatin Tregan, Elbasan , për veprën penale "Prerja e paligjshme e pyjeve", u kap duke transportuar 4 m3 lëndë drusore me mjetin kamioçin tip "Benz", pa dokumentacionin përkatës.

—-

Në Komisariatin e Policisë Elbasan ka bërë kallëzim shtetasi N. G., 43 vjeç, banues në lagjen "Shënkoll", Elbasan, se i është larguar nga banesa dhe ka humbut kontaktet me vëllain e tij shtetasin E. G., 45 vjeç, i cili punonte si bari në qytetin e Vlorës. Punohet për gjetjen e tij.

Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, për veprime të mëtejshme.

Share | Share | Share | Share | Email

Durrës – Vihen në pranga 4 shtetas, njëri prej tyre në kërkim

Vlorë – Arrestohet 1 shtetas, shpallet në kërkim 1 tjetër, për vepra të ndryshme penale

Kërko
Enter a word for search

Komisariati Dixhital
GET IT ON Google Play
Download on the App Store

Arkiva
Select Month

Linqe
Arkiva
Akademia e Sigurisë
Ministria e Brendshme
Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
Interpol
Europol
Misioni PAMECA V
SCPA
Projekti Trivalent

Copyright © 2022 Policia e Shtetit.